Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Taksa postale e paguese

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

DEL DY HERE NE JAVE: T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorashkrimet nuk kthehen

Drejtori pergjegjes SEDAT BIDA

Vjeti IV Nr. 166 | PRISHTINE, e ejte 9 Dhetuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Problemet organizative te Frontit populluer

(Nga referati i shokut Bllagoje Neshkoviq, mbajte ne Plenumin e Keshillit te perbashket te Frontit populluer

Ne seancen plenare te Keshillit te perbashket te Frontit populluer te Jugosllavis Dr. Bllagoje Neshkoviq mbajti referatin ne lidhje me problemet organizative te Frontit populluer. Ai ne mes te tjerash tha:

„Qysh ne fillim te shtatorit te ketij vjeti shoku Tito i ka ngarkue per detyre sekretarijatit te Keshillit egzekutiv te Keshillit te perbashket te Frontit populluer te Jugosllavis per me e shqyrtue gjendjen organizative te Frontit populluer. Sekretarijati ka organizue mbledhjen e materjalit, përveç tjerash tue dergue ekipa te veçanta ne te gjitha organizatat republikane te Frontit populluer, ne baze te se cilës pune jane konstatue disa perfundime mbi gjendjen e tashme organizative te Frontit populluer. Mue me asht ngarkue per detyre qe t'ju njoftoj me ato perfundime.

Keshilli egzekutiv i Keshillit te perbashket te Frontit populluer te Jugosllavis nuk disponon sot shenime te perpikta mbi punen e organizates se Frontit populluer, veçanerisht nuk e disponon pasqyren e perpikët te tana akcioneve punuese te kryeme prej organizatave te Frontit populluer gjate periudhes se kalueme te ketij, por disponon me shenime te cilat flasin kjartaz mbi suksesin e punes s'organizatave. Me njihere mund te thuhet se ka qene krejte e jashtezakonshme inicjativa e shokut Tito per konstatimin dhe shqyrtimin e gjendjes se deri tashme t'organizatave te Frontit populluer. Edhe Kongresi i Peste i PKJ ka prue vendime te randesishme mbi Frontin populluer. Ne pjesen e katert te programit te PKJ flitet veçnas dhe gjanesisht mbi Frontin populluer. Nota e deri-tashme mbi gjendjen e organizatave te Frontit populluer duhet te filloje nga nota e pergjithshme e Frontit populluer, e cila gjindet ne vendimet e Kongresit te Peste te PKJ, sepse Fronti populluer nuk mund te mendohet pa rolin udheheqes te PKJ.

Fronti populluer ka randesi kolosale per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. Çdo nençmim i randesis se Frontit populluer asht me i njelle direkt dame Partis Komuniste te Jugosllavis, popujve te Jugosllavis, veprës se ndertimit te socjalizmit ne Vendin t'one.

Me programin e PKJ thuhet se Fronti populluer ka... randesi kolosale... per mobilizimin e turmave ne lufte per socjalizem. Per ngritjen e koshjences se turmave dhe per perforcimin e bashkimit moralo-politik te popujve... „(Programi i PKJ IV).

Ne kete mbledhje nuk po parashtrohet nji raport te perpiket mbi te tane punen e organizatave te Frontit populluer, por vetem problemet themelore kryesore, esencjale nga puna e organizatave te Frontit populluer, zgjidhja e drejte e te cilave, padyshim do t'i ngrejë organizatat e Frontit populluer ne pune, e cila pritet prej tyne ne t'ardhmen".

Gjendja e pergjitshme e organizatave te Frontit Populluer te Jugosllavis dhe nji dobesi e pergjitheshme

„Aktiviteti i Frontit populluer gjate vjetit 1948 ka qene shum i gjalle dhe i gjithllojshem ne mbare RFPJ. Puna e organizatave te Frontit populluer asht permirsue mjaft gjate vjetit 1948 ne krahasim me vjetet e kalueme. Puna e organizatave te Frontit populluer pasunohet me forma te reja, te cilat perfaqsojne zhvillimin e matejshem te disa veçantive, shum te randesishme per ndertimin e socjalizmit. Tue e marre ne baresi, asht permirsue puna politike dhe organizative si dhe gjendja e organizatave te Frontit populluer, shka tregon perforcimin e matutjeshem te bashkimit te shtresave punuese dhe mbi aktivizimin e tyne te gjane ne lufte per plan, ne lufte per socjalizem. Sukseset e mbrrijtuna ne punen e organizatave te Frontit populluer e vertetojne edhe drejtesin e politikes se PKJ, KQ te PKJ, me shokun Tito ne krye, sepse drejtesija e asaj politike vertetohet me vepra, me anen e eksperiences se vet te miljona punetorve te Vendit t'one".

Mandej Dr. Neshkoviq citoi te gjenerit mbi gjendjen n'organizatat e Frontit populluer nga raportet e keshillave egzekutive te keshillave kryesore mbi punen nand mujorshe te Frontit populluer. Ne keto raporte vehet ne dukje se asht shtue fuqishem autoriteti i Frontit populluer, organizatat i kane ngrijte me sukses turmat ne gara te gjana per ndertimin e shtepijave kooperative, ne realizimin e detyrve te mbjelljeve pranduerore, ne kryemjen e regjistrimit te popullsis, ne zhvillimin e tregtis me çmime te lidhuna, ne realizimin e planit shtetnuer etj.

„Nepermjet te ketij aktiviteti jane forcue edhe ma teper rradhet e Frontit populluer, asht forcue edhe ma fort bashkimi moralo-politik i turmave, antaret e Frontit populluer si dhe populli asht bashkue edhe ma fort rreth Partis s'one Komuniste te Jugosllavis dhe KQ te PKJ, me shokun Tito ne krye".

„Padyshim — tha Dr. Neshkoviq," puna e deritashme e organizatave te Frontit populluer dhe sukseset ne punen e tyne tregojne se çfar fuqije perfaqsojne shtresat punuese te Vendit t'one kur organizatat e Frontit populluer nen udheheqjen e organizatave te PKJ e bashkojne dhe perqendrojne punen e tyne drejte qellimit te caktuem. Turmat milionshe punuese te Vendit t'one jane te lidhuna me lidhje te pa-shkeputuna per Frontin si me perfaqesuesin e bashkimit te turmave punuese, pa marre parasysh inaktivitetin e perkohshem te nji pjese t'antarve n'organizatat themelore te Frontit. Me qinda mija njerez marrin pjese aktive dhe vazhdimisht ne punen e vet organizatave te Frontit, ata edukohen e ngriten politikisht dhe ideologjikisht n'organizatat e Frontit populluer. Se kendejmi keto rezultate te shumta dhe te mdhaja ne punen e Frontit populluer. Kur te çmohen nga ky drejtim sukseset e Frontit populluer na at'here muejme dhe diçmos do te jemi te knaqun me punen dhe sukseset e organizatave te Frontit populluer. Me rastin e te çmuemit te ketille t'organizatave te Frontit populluer, na mund te jemi te sigurte se nuk vuejme nga „dehja prej sukseseve". Por, tue e marre parasyshe, se puna dhe sukseset e deritashme t'organizatave te Frontit populluer perfaqesojne nji pjese te dukshme te punes qe pritet prej Frontit populluer, por edhe se organizatat munden me dhane prej vedi edhe ma teper se deri tash, na nuk guxojme dhe nuk muejme me qene krejte te knaqun me punen edhe sukseset e deritashme t'organizatave te Frontit populluer. Me nji fjale, gjendja e organizatave te Frontit populluer nuk asht krejt e knaqeshme.

Gjendja e organizatave te Frontit populluer nuk asht krejte e knaqeshme, per shkak se puna e tyne, prap, mbetet mbas me disa mundesi te paçfrytezueme, te cilat do te sherbejshin ne lufte per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one.

Te cilat jane keto mundesi te paçfrytezueme ne punen e organizatave te Frontit populluer?

Mundesit e paçfrytezueme per permiresimin e punes se Frontit populluer gjinden n'organizaten themelore te Frontit. Inaktiviteti i disa antareve te Frontit populluer n'organizaten e vet themelore, veçanerisht ne katund, asht vuejtje ne gjum te fuqive kolosale, mos efrytezimi i rezervave politike kolosale per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one.

Shembuj te shumt, nga organizatat e te gjitha republikave, mund t'a vertetojne gjendjen e dobet ne disa organizata te Frontit populluer.

Ne Serbi, ne disa katunde malore vetem gjate kesaj vere asht krye formimi i keshillave te Frontit, e ne disa vende konferencat mbahen zakonisht atehere kur te vjen dikush nga aktivi i agjitatorve nga qendra e rrethit.

Ne Kroaci, ne disa rrethe, puna e Frontit populluer ka qene aq e lanun mbas dore, sa qe ka qene e nevojshme qe ne disa katunde te formohen keshillat inisjative, qe te kryheshin pregaditjet per zgjedhje n'organizatat themelore te Frontit.

Kurgja ma mire nuk asht as gjendja ne shum vende t'organizatave tjera republikane te Frontit populluer.

Ku qendron shkaku i kesaj çfaqjeje? Shkaku i kesaj çfaqjeje asht puna e dobet e udheheqsinave pergjegjese te Frontit populluer. E gjendja e ketille ne udheheqesinat e Frontit populluer asht krijue nga qendrimi i pakujdesshem dhe i papergjegjesi i udheheqesave perkates te Partis e te tjere ndaj organizates se Frontit populluer".

Mbassi vueni ne dukje se egzistojne te gjitha kushtet per permiresimin e gjendjes n'organizatat themelore te Frontit, Dr. Neshkoviq tha:

„Me gjithese organizata themelore e Frontit asht pika ma e dobet ne punen t'organizatave te Frontit populluer, prap se prap dobesinat e saje mund t'evitohen vetem ne permiresimin e njikohshem te punes te te gjithe trupave udheheqes te Frontit populluer, — dhe me perqendrimin e vemendjes se tyne per zgjidhjen e problemit te punes t'organizates themelore te Frontit.

Per me u permiresue gjendja e organizatave te Frontit populluer, ne pergjithesi, si dhe t'organizatave themelore te Frontit, veçanerisht, duhet patjeter te zgjidhen nji varg problemesh organizative.

1) Lufta kundra iluzioneve

Per permiresimin e punes s'organizatave te Frontit populluer asht shum e randesishme qe te çmohet realisht puna e tyne. Ngjane nga ndonjihere qe nuk dallohet çka asht rezultat i vertete i punes s'organizatave te Frontit populluer, e çka asht rezultat i punes direkte t'organizatave te tjera. Prandaj ngjane qe ose te çmohen shum rezultatet reale te punes s'organizatave te Frontit populluer ase te nençmohen, qe te gjitha rezultatet e punes s'organizatave te Frontit populluer te kalohen sikurse te mos egzistonte Fronti populluer.

Mandej Dr. Neshkoviqi foli ma gjate mbi çfaqjet e te çmuemit ireal te punes s'organizatave te Frontit populluer.

Dergimi i akteve nga nji keshill egzekutiv i organizates se Frontit populluer nuk mund te merret si pune e organizates se Frontit populluer ne çashtjet e caktueme, si kontribut i Frontit populluer ne zgjidhjen e detyreve te mdhaja te ndertimit te socjalizmit, ne qofte se organizatat e Frontit populluer nuk punojne, ase ne qofte se nuk angazhohen ne pune ne baze t'atyne direktivave.

Nuk mund te mendohet se egziston aktiviteti real i organizates se Frontit populluer n'ato raste kur ky aktivitet permblidhet vetem ne nji konference politike njiorshe, te cilen e mban nji agitator ne çdo 15 ase 20 dite, i derguem ne nji organizate themelore nga rrethi ase qyteti.

Sipesh here i tane aktiviteti i Frontit populluer permblidhet vetem n'ate forme, pa aktivitetin e organizates themelore te Frontit dhe t'udheheqesis se saje. E perveç kesaj, aktiviteti i ketille çmohet si „pune" e organizates themelore e Frontit populluer. Te çmuemit e ketille t'aktivitetit t'organizatave te Frontit populluer tregon se ata qe e çmojne keshtu jetojne n'iluzjon, se nuk muejne, ase nuk duen me i pa punet me sy. E iluzjonet jane mjeti ma i rrezikshem vetmposhtjes. Deri sa te jetohet n'iluzjone, gjendja n'organizata nuk mund te permirsohet as per nji qime, e kur te mos permirsohet atehere sigurisht keqsohet.

Per kete arsye, lufta kundra iluzjoneve asht nji nga kushtet e para qe te permirsohet gjendja e tashme e organizatave te Frontit populluer.

2) Puna politike — baze per krejt punen e Frontit populluer

Siç asht e njoftun Fronti populluer asht organizate politike.

Puna politike duhet te jete permbajtja kryesore e punes s'organizatave te Frontit.

Me gjithe ate puna politike nuk asht aq mire e organizueme n'organizatat e Frontit populluer.

Diku diku pamja politike e Frontit populluer asht shemtue. Shoket te cilet i kane vizitue organizatat e Frontit populluer, kane konstatue per shembull ne Bosne e Hercegovine qe ka udheheqsat e disa organizatave themelore egziston mjaft i perhapun mendimi se n'organizata e Frontit populluer nuk duhet te hyjn njerez te vjeter, sepse nuk munden me marre pjese n'akcjonet punuese te Frontit populluer. Kjo flet se pamja e Frontit populluer, pamja e organizates politike, asht shemtue. Si per punen politike, ne kete raste nuk mund te bahet as fjale.

Atehere nuk asht e çuditshme kur ne procesin e keshillit te vendit Lubinje, rrethi Stollaqkit gjindet edhe keto fare vendimi:... „qe te kujdesohen se sa ka dhane prej vedi çdo antar Fronti dhe se kush nuk pergjigjet per ne punen e Frontit, te merren parasyshe me rastin e caktimit te taksave mbi t'ardhmat...".

Por mungesa e plote e punes politike dhe luftes politike asht edhe llojin e dyte te shemtimit te pamjes se Frontit populluer. Per shembull, ne Slloveni puna politike dhe lufta politike ne katund asht zhvillue aq dobet nga disa organizata te Frontit populluer, me komunistat ne krye, se katundi nuk asht burim i fuqis punetore per nevojat e industris, porse qyteti asht burim i fuqis punetore per nevojat e katundit (Trbovlje Cele). Rast i ketille ka qene per shembull ne nji katund afer Mariborit, ku egziston fabrika e tullave. Per t'a siguruar fuqija punetore per fabriken e tullave te ketij katundi, asht dergue nga qyteti nji brigade e rinis e perbame prej 50 te rijve.

Por, gjendja e ketille e punes politike nuk asht vetem ne disa organizata te Bosnes e Hercegovines dhe te Sllovenis. Gjendja e ketille asht edhe ne shum vende t'organizatave tjera republikane.

Derisa turmat punuese te Vendit t'one i plotesojne me hovin kolosal dhe me vetmohimin fisnik te gjitha detyrimet ndaj ushtarit te tyne socjalist ne ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one, agjitacjoni dhe propaganda e jone e Frontit me shkrim

(Vazhdim ne faqen e dyte)

Problemet organizative te Frontit populluer

[illegible]

Me punë politikisht don me thanë [illegible]

[illegible]

3) Fronti populluer dhe lufta e klases

[illegible]

[illegible] kaq sot [illegible] popullit [illegible] i popullit t'onë, por do te perforcohet, sepse na kurr nuk kemi konsiderue si „popull" ashtu borgjezi, porse kjo ka qenë dhe asht kundra popullit, çka e ka provue shum here me vepra, çka, fundi i fundit, e proven edhe sot. Populli-janë turmat punuese te qytetit dhe te katundit: klasa punture, turmat punuese te qytetit, katundarija e mesme dhe e vorfen, inteligjenca popullore. E per te mundë me iu afrue cashtjes se luftes per ndertimin e socjalizmit nga ana shkencore, na duhet me u kujdesue mbi perbamjen e klases se popullit, jo-qe t'a dobsojshim fuqin e tij, por qe t'a fuqizojshim dhe t'a forcojshim, tue u kujdesue mbi vetite specifike dhe interesat e çdo klase dhe shtrese njerzish qe hyn ne perndvajtjen e tij, e per t'i lidhe interesat e tij mule per cashtjen e ndertimit te socjalizmit.

Kur i ekspozoi te gjitha keto, kam partiayshe programin e PKJ ku thuhet:

„Ka qene gjë themelore ne Frontin Fpopulluer te Jugosllavis dhe mbetet per gjithmone: bashkimi i turmave". (Programi i PKJ, IV, Fronti populluer).

Dhe mandej:

„...zgjanimi i rradheve te Frontit populluer me njerezit punues te cilet ende nuk jane inkuadrue ne Frontin populluer, e njikohesisht pastrimi i Frontit populluer nga elementat anmiq dhe te huej per interesat e popullit punues..." (Programi, IV. Fronti Populluer).

Ne kuadrin e luftes kundra anmikut te ndertimit te socjalizmit Fronti populluer pa tjeter duhet t'a organizoje dhe t'a udheheqe, me komunistat ne krye, luften kundra popave anmiq, kundra klerit qe punon ne menyre anmiqesore, te cilet jane kundra interesave te popullit, kundra ndertimit te socjalizmit. Kjo lufte pa tjeter duhet te zhvillohet, krahas me perpjekjet e Frontit populluer, qe te gjithe kleriin e ndershem, per sa i perket interesave te ndertimit te socjalizmit dhe te mbrojtjes s'interesave te RFPJ, t'a terhjeki dhe t'a aktivizon ne punen e organizatave te Frontit populluer. Lufta kundra anmikut nga rradhet e kishes kerkon perpjekje dhe metoda te veçanta ne punen politike t'organizatave te Frontit populluer. Por, nuk duhet me harrue se nga nji ane, keta popa anmiq jane mbrojtesa t'interesave t'eksploatorve [illegible]

[illegible]

Prandaj detyra themelore e Frontit populluer, nen udheheqjen e PKJ, asht t'a organizoje krejt dhe t'a zhvilloje me energji luften politike, luften per sigurimin dhe sigurimin e interesave te popullit t'one.

Puna e organizatave te Frontit ne lidhje me punen e organizatave te Partis

Partija Komuniste e Jugosllavis asht [illegible] dhe organizatore e Frontit populluer te Jugosllavis, ajo ka rolin udheheqes ne Frontin populluer te Jugosllavis. [illegible]

[illegible]

Qe shka thote shoku Kardel ne lidhje me ket pune ne referatin e tij ne Kongresin e Peste:

„Ne te gjitha organizatat masovike, e aq ma teper ne Frontin populluer, politika e PKJ asht shtrue nen kontrollin dhe kritiken direkte te turmave punuese" (Kongresi i Peste i PKJ, raportet dhe referatet, faqe 382, „Kultura").

Prandaj puna e organizatave te Partis ne lidhje me punen e organizatave te Frontit duhet t'a bajne te mundshem nji marredhanje te drejte ne mes t'organizatave te Partis dhe t'organizatave te Frontit. [illegible]

5) Fronti populluer dhe inspeksjoni populluer

[illegible]

—o—

Problemet organizative te Frontit populluer

punuese jane ne pozite te persistat-shme një i shullue ne kohe nji varg punëtrejtimash dhe punesh te dam-shme te disa njesive t'aparatit shte-tnor dhe kopecatis. Prandaj ne baze te vendimit te Qeveris qendrore asht fillue puna per formimin e organit t'inspekcjonit populluer ku Fronti po-populluer ane vend me randesi.

Qellimi i fundit i punes t'organit t'inspekcjonit populluer asht i njajte me ate t'organit te kontrollit te per-gjithshem shtetnuer, e ky asht me i „shtye" organet ekonomike dhe ad-ministrativo-operative, organet shtet-nore dhe kooperative per ani e orga-nizimit, perairtimit dhe perforcue kon-trollin e vet mbi kryemjen e detyrreve te tyne nga ana e aparatit te vet.

6) Pjesemarrja e antareve te sindi-katave t'unjisuem ne punen e orga-nizatave te Frontit populluer

Tue fole mbi marredhanjen ne mes te sindikatave t'unjisuame dhe te Fron-tit populluer Dr. Neshkoviq vueni ne dukje se kjo ne princip shtrohet drejt gjithkund. Mirepo, ne prak-tiken e disa organizatave realizohet gabueshem pjesmarrja e antareve te sindikatave t'unjisueme ne punen e organizates se Frontit populluer.

„Organizata sindikale asht shkolle e komunizmit. Ajo simbas perbamjes se saje te klases dhe rolit ne nder-timin e socjalizmit asht shtylla ma e forte e pushtetit populluer. Fronti populluer asht forma organizative kou kreh e aleances se klases puntore dhe turmave tjera punuese. Ketu qen-dron randesija e madhe e Frontit populluer. Njena organizate (sindi-kati), nuk e perjashton tjetren (Fron-ti populluer). Perkundrazi organizata sindikale asht edhe berthama e kla-ses, ma e forta e Frontit populluer. Qe te mundet organizata sindikale me qene e lidhe ne Frontin popullu-er, antaret e organizatave sindikale duhet pa tjeter te marrin pjese ne punen e organizatave te Frontit po-populluer.

Mbasi vueni ne dukje kritiken e mbamjes s'antareve te disa organiza-tave sindikale nga puna politike dhe puna tjeter e organizatave themelore te Frontit Dr. Neshkoviqi tha:

„Per ket qellim mendoj se duhet me e pre energjikisht praktiken e deri-tashme te mos marrjes pjese t'anta-reve te sindikatave tunjisueme ne pu-nen e disa organizatave te Frontit, praktiken e krijimit te nji-tje te punes, si te Frontit ashtu edhe sindikale, jashte njisive punuese t'organizatave teritorijale te Frontit. Ndoshta do t'i-shte vetem rastesisht e nevojshme qe organizata sindikale t'organizoje veç-mas nji pune vullnetare, por kjo do t'ishte me te vertete situate e veçan-te dhe speciale. Nga perpjekja akti-ve e sindikatit ne lidhje me kete çashtje mvarret se sa shpejte do te zhduken keto anomali nga puna e organizatave te Frontit. Asht detyre e jona qe te kerkojme ndreqjen e gjendjes n'organizatat e Frontit po-pulluer ne lidhje me ket çashtje.

7) Mbi aksionet e punes dhe mbi nji-sit e punes te Frontit populluer

Te gjithe e kuptojme randesin e shum çmueshme te punes vullnetare, zhvillimin e se cilen e organizon Fron-ti populluer. Por na, prap shpesh e çmojme çfaqjen masovike te punes vullnetare vetem nga ana e saje mo-mentale materjale. Kur punojme ke-shtu, padyshim gabojme. Shoket t'o-ne ne terren i menojne edhe ma teper keto gabime: tue u ngute per efekte te punes, shpesh here shoket t'one nga terreni punojne ashtu sa qe prej punes „vullnetare", mbetet vetem emni. Keto gabime bahen per shkak se shum shpesh lehet mbas dore gjaja kryesore ne çfaqjen e pu-nes vullnetare: lehet mbas dore ma rendesia kushtetuese ndaj punes n'in-teresa e ndertimit te socializmit.

Te na puna vullnetare ka marre perpjestime shum te gjana. Kjo pune se shumicen dermuese asht me te vertete pune vullnetare, e ma se shum se edhe pa pagese. Te gjitha shkaqet kane bere qe edhe na intuziazmohemi me çfaqjen e „subotnikeve" (te shtu-nave te punes), si asht entuziazmue dikur Lenini i pavdekshem me çfaq-jen „e subotnikeve" ne BRSS.

Te na po perfeksjonohen pa nder-pre format e punes vullnetare. Çfaq-ja e brigadave t'aksionarjeve te ve-çanta te Frontit populluer ka randesi kolosale per zhvillimin e socjalizmit te na, ne vend te pare per shkak t'in-kuadrimit kushtet vullnetar te ka-tundaris ne punet jashte vend-banimit te tyne te perhershem. Randesija e ketyne njisive te punes mbetet plote-sisht e njajte pa marre parasysh se pjesmaret e tyne u paguhen. Keto brigada jane vullnetare pa marre pa-rasysh se jane „pa pagese" — se fendejmi rrjedh randesija e tyne te dukshme, perveç tjerash, perspektivat kolosale te cilat po hapen per zgjidh-jen e problemeve te fuqis puntore me çfaqjen e ketyne brigadave punuese, vullnetare (te cilat ndoshta edhe du-het te quhen keshtu).

Per te mujte me e mbajte dhe me e zhvillue drejte ket fitore te randesi-shme te revolucjonit t'one populluer socjalist — punen vullnetare — du-het, ne vend te pare me e pengue shtrembnimin e punes „vullnetare" dhe t'a ndalojne qendrimin e pa-drejte ndaj punes vullnetare. E mbi keto determinime dhe padrejtsine fla-sin shembuj te shumt, te cilet mund te permbledhen si vijon:

1) Ne detyrimin e njerzve me ma-rre pjese n'aksjonet e Frontit, direkt ase indirekt.

2) Ne perpilimin e planeve te pu-nes se Frontit ne zyret shtetnore ase ne forumet ma te nalta udheheqese te Frontit populluer, pa pjesmarr-jen (dhe vendosjen rreth tyne) e atyne qe duhet t'i zbatojne.

3) Ne ne„çmimin dhe trillimin e argumenteve te shumta jo serioze per qendrimin negativ ndaj planeve te punes vullnetare te Frontit populluer dhe te brigadave punuese vullnetare te Frontit populluer, çka ne realitet asht oportunizem dhe politike kula-ke ne katund.

Rezolucjoni i Byros Informative dhe Fronti populluer

Rezolucjoni i Byros Informative nuk i ka ngaterrue marredhanjet ne mes te PKJ dhe te FPJ, ne saje te poli-tikes se drejte te KQ te PKJ me shokun Tito ne krye. Ka pase disa mos kuptime vetem ne disa organi-zata, nga turbullimi qe e shkaktoi Rezolucjoni, te disa shoke me ni-vel t'ulte ideologjik.

Mbas shpalljes se Rezolucjonit t'In-forma Byros, per asnji moment nuk ka pase lekundje te masat kolosale dhe antaret e PKJ si dhe te antaret e FPJ, persa i perket punes ne se Fronti populluer asht i nevojshem apo jo. Ky qendrim rrjedh nga ai i krejt Partis dhe i krejt Frontit populluer, ne pergjithesi, ndaj akuzave te padrejta ne Rezolucjonin kundra KQ te PKJ me shokun Tito ne krye, kundra PKJ dhe RFPJ. Siç mund te konstatohet Rezolucjoni i Byros Informative ka shkaktue me te vertete luhatje ne lidhje me çashtjen e Frontit populluer dhe heshtjen e Frontit populluer ne disa shtete te tjera. Por vet jeta edhe problemet qe i shtron kjo, i shtyne shum „kriti-kues" te PKJ qe perseri t'a ngjallin dhe t'a riaktivizojn Frontin populluer ne vendet e tyne. Kush nuk e ban sot ket, sigurisht do t'a baje neser nen presjonin ma te madh te kush-teve objektive te ndertimit te socja-lizmit ne rrethanat e tashme n'ato shtete. Me keto fakte perseri po ver-tetohet qendrimi i drejte i KQ te PKJ me shokun Tito ne krye, ne lidh-je me Rezolucjonin e Byros Infor-mative.

Padrejtesija dhe pajustifikueshme-nija e akuzave te Rezolucjonit te By-ros Informative i kane forcue rra-dhet e Frontit populluer rreth PKJ, e antaret e PKJ rreth KQ me sho-kun Tito ne krye. Kjo gja asht shprehe edhe me anen e Rezolucjoneve, te cilet i kane prue organizatat e Fron-tit populluer ne lidhje me Rezoluc-jonin e Byros informative, perfun-doi referatin Dr. Neshkoviqi.

Tue i pague tatimet ne kohe-ndihmohet dhe shpejtohet rithmi i ekonomis s'one socjaliste

Pagimi i te gjitha llojeve te tati-mit ne Krahinen t'one ne kohet e fundit asht ngjalle bukur fort, e sido-mos ne ato rrethe ku keshillat te rretheve, te rretheve te qyteteve an-gazhohen ma te teperti, tuke pase ndihmen e madhe edhe t'organizata-ve masovike te ku punet investicio-nale zhvillohen ma mire, ku asht ma i forte agjitacjoni dhe propaganda mbi çashtjen e randesis se pagimit te tatimit per permiresimin te standar-dit jetesuer te njerezve t'one puno-njes dhe per forcimin t'ekonomis te Vendit t'one.

Plani i pagimit te tatimit per ket vjet asht realizue deri me 1 dhetuer ne gjithe Krahinen t'one me 84%. Tatimi ne t'ardhunat e puntoreve dhe nepunesave asht pague deri tash 78% ne t'ardhunat nga bujqesija 86%, e ne t'ardhunat e zejtaris private dhe te pasunis ne 83%. Pagimi i tatimit ne qarkullimin e prodhimeve asht realizue gjithashtu mjaft mire. Si-mbas shenimeve, deri me 30 nan-duer asht pague ne 89% nga plani i parapame. Ma se dobti qendron pagimi i tatimit ne trashigimi. Ky lloj tatimi asht realizue deri tash ve-tem ne 65%.

Pagimi i tatimit nga t'ardhunat e bujqesis realizohet ma se miri ne rrethin e Lipljanit, ku ka arrijte ne 99%, dhe ne rrethin e Istokut ne 95%. Plani i pagimit te tatimit mbi t'ardhunat e zejtaris dhe pasunis pri-vate ne qytetin e Prishtines asht rea-lizue dhe tejkalue me 163% e ne Mit-rovice ne 104%. Realizimi i planit te pagimit ne trashigime ne rrethin e Lipljanit dhe te Drenices asht rea-lizue e tejkalue ne 144%, e n'ate t'Istokut ne 119%.

Pagimi i tatimit ne qarkullimin e mallnave asht pague ma se miri ne rrethin e Suharekes, ku asht reali-zue ne 227%, mandej ne rrethin e Podujeves ne 198%, dhe ne rrethin e Prizrenit ne 154%. Rezultatet e e siperme paraqesin kjartë se anga-zhimi i keshillave te rretheve dhe i organizatave masovike ka qene ne naltesimin e duhun dhe se zgjidh-jes se kesaj çashtje i jane perveshe me mjaft gatshmeni, seriozitet dhe dashuni.

Rezultatet e dobta ne pagimin te tatimit t'ardhunat e zejtaris dhe pa-sunis private jane arrijte ne qytetet Prizren dhe Peje, ku plani i pagimit te ketij tatimi ka arrijte vetem ne 41%. Ne qytetin e Prizrenit nuk ka shkue mire gjithashtu edhe pagimi i tatimit ne trashigimi, e cili nuk ka kalue ma se 11%.

Pagimi i tatimit ne t'ardhunat nga bujqesija zhvillohet ma se dobti ne rrethin e Ferizajt, ku plani asht plo-tesue vetem ne 57%. Ne ket rreth keshtu shkon edhe pagimi i tatimit ne trashigime, ku deri me nji dhetuer plani ka arrijte vetem ne 25%. Nga ket asht kuptohet se angazhimi i keshillave popullore te rretheve, te qyteteve dhe te vendeve si dhe t'or-ganizatave masovike ne keto vende ka qene mjaft i dobet dhe te kesaj çashtje nuk i asht kushtue kujdesi dhe pregaditja e nevojshme sikur rrethet e qytetet ku jane kurre situata ma te mira. Kjo vlene ma se teperti per rrethin e Ferizajt dhe te Podu-jeves si dhe per qytetet Peje e Prizren.

Tue e pase te gjitha te njoftun se pagimi i tatimit plotesisht nalti-mohet kryesisht zhvillimi ekonomik t'one socjaliste, asht e nevojshme qe jo vetem keshillat popullore te rre-theve, por edhe organizatat masovike t'i kushtojne kujdes ma te madh ketij problemi kaq me randesi per Kra-hinen dhe mbare Vendin t'one.

Nga inspektimi i seksjoneve te tregtis

Inspekcjonet e tregtis prane keshi-llave popullore te qytetit e te rre-thit per nji ndamje te drejte te tris-kave t'ushqimit dhe t'industris, ne keto dite kane krye kontrollimin te ketyne kartave ne teritorin e Krahines s'one. Me rastin e revizionit asht [illegible] nji seri gabimesh dhe pa-kujdesi ne ndamjen e kartave per furnizim. Duhet te theksohet se ndo-nji shperdorim me qellim nuk ka pase, por gabimet dhe te metat ka-ne rrjedhe ma teper per arsye te mosnjoftjes se mjaftueshme te punes.

Asht konstatue se ne shum keshilla popullore te vendeve, te rretheve dhe te qyteteve, asht e dobet evidenca e kartave te furnizimit. Nuk jane mbajte regjistrat dhe kartotekat mbi dhanjen e kartave, keshtu qe nuk ka mujte me u konstatue se kush ka te drejte me pase trisken, nuk ka mujte me u ba kategorizimi i kon-sumatoreve, sepse ne lista nuk jane shenue detyret e sakta t'interesuem-ve dhe puna qe e bajne. Per kete arsye ka ngja qe triskat e furnizi-mit u jane dhane atyne personave qe nuk kane te drejte me e pase, e nga ana tjeter nuk kane marre ato qe kane te drejte me pase triska.

Kesi rastesh ka pase shumë ne rrethet: Dragash, Serbice, Ferizaj dhe Suhareke. Ne rrethin e Dragashit dhe te Gilanit, puntoreve qe u kane lane punen nuk u jane marre triskat, por u jane lane qe t'i çfrytezojne edhe ma vone. Ne Gilan konsumatoreve nuk u jane pre kuponat per gja-nat e ndryshme ushqimore, por te tent u jane ra vise, keshtu qe u asht dhane mundesi pronareve te trieka-ve qe te bajne shperdorime. Ne KPV Porhieranje ne rrethin e Gilanit pu-na rreth triskave i ka qene lane kuri-rit. Per shkak t'evidences se dobet, prevoditi i triskave te furnizimit asht ba ne shumicen e keshillave popullore te rretheve e te qyteteve me keqen-dje, keshtu qe ka pase raste qe te mungojne triskat, ase per kah kate-gorija ase pergjithesisht gja per te cilen asht ba korigjimi i triskave dhe pune te tjera jo te rregullta. Ka pase edhe asi rastesh, kur nga mungesa e triskave t'ushqimit jane kopjue tris-kat (p. sh. ne KPV Banja ne rrethin e Istokut).

Me rastin e revizionit te triskave te furnizimit nga ana e inspekcjonit te tregtis prane keshillave popullore te rretheve dhe te qyteteve jane hjek ne Krahinen t'one nga furnizimi i si-gurum gjithsejt 2.425 persona qe kane perfitue nga triskat e furni-zimit e nuk kane pase te drejte. Man-gojne shenimet nga qyteti i Prish-tines, rrethi i Kamenices dhe i Vushtr-rnes, ku nuk ka marre fund revi-zioni. Perveç ketyne triskave, ne mbare Krahinen jane marre gjithsejt edhe 3,141 triska t'industris prej atyne per-sonave te cilet nuk kane pase te drejte.

Gabime ma te madha ne dhanjen e triskave t'ushqimit dhe t'industris jane ba ne rrethin e Dragashit, ku jane hjeke, me rastin e revizionit, nga furnizimi i sigurum 2.223 kon-sumatore dhe u jane marre 2.153 triska t'industris atyne personave qe nuk kane pase te drejte me i pase. Mbas rrethit te Dragashit, gabime ma te medha jane ba ne rrethin e Mitrovices, ku jane hjeke nga fur-nizimi i sigurum 936 persona, mandej ne rrethin e Ferizajt jane hjeke nga furnizimi i sigurum 793, ne rrethin e Rahovecit 554 dhe ne rre-thin e Serbices 436 persona.

Perveç gabimeve rreth dhanjes se triskave, ka pase gabime edhe nga ana e te besuemve te grupeve te puntoreve prane disa sipermarrjeve te cilet e kane shperdorue detyren, qe u asht besue. Keshtu per shkak te shperdorimit te triskave t'ushqi-mit dhe t'industris, te besuemit te grupeve te sipermarrjes se tullave dhe te tjegullave ne Prishtine, [illegible] Dra-gi dhe Vlada Petroviq, u gjobiten i pari me 8.000 dinare dhe i dyti me 2.000 dinare. Gjithashtu per ar-sye te shperdorimit te triskave t'ush-qimit dhe t'industris, ne Prishtine jane denue edhe 17 persona.

Ne minieren e magnezitit "Golesh" u deklaruen 31 sulmues dhe 90 puntore te tjere u lavdruen dhe u shperblyen

Tue e festue festen e madhe te shpalljes se Republikes s'one - 29 nandorin, kolektivi punues i minie-res se magnezitit „Golesh" e ka ana-lizue punen e bame ne vjetin e dyte me plan si dhe rezultatet e mberiti-tuna gjate garave. Detyrimet e ma-rruna per siper ne lidhje me nxjerr-jen e mineralit te paperpunuem jane plotesue 57 dite para afatit te caktuem me plan e 16 dite para premtimit te dhanun per me ndere te dites se Republikes s'one. Detyrimet e marru-na persiper ne lidhje me pjekjen e mineraleve do te plotsohen n'afatin e caktuem. Edhe ne kete drejtim do te tejkalohet plani sikur te mos mun-gonte furra perkatse.

Deri ne Diten e shpalljes se Re-publikes jane mbajte 22 keshillime rreth prodhimit te cilat kane ndikue shum si per kah sasija ashtu edhe per kah cilsija e prodhimit. Perveç kurseve te shumta jane mbajte edhe kurse per puntore te kualifikuem dhe te gjyskualifikum, ne kete menyre 51 puntor i kane fitue diplomat e kuali-fikimit dhe 12 puntor diplomat e gjys-kualifikimit. Keto shifra perbajne 97% te krejt numrit te pjesmarrsave ne keto kurse. Kursin analfabetik e kane vijue rregullisht 76 puntor prej se cilve kane kalue ne provime 58 puntor. Perveç kesaj kolektivi ka or-ganizue 31 grupe leximi. Ne saje t'aktivitetit te deges sindikale dhe t'an-tarve te saje kolektivi ka dhane 25.380 ore pune vullnetare ne udreqjen e rrugeve, per nderimin e shtepijave koperative dhe ne pune bujqsore.

Ne saje te ketyne perfundimeve e ne konferencen qe u-mbajt me rastin e festes 29 nanduer, ne kete kolektiv u-shpallen 31 sulmues dhe 90 pun-tor u-lavdruen dhe u shperblyen ne te holla. Sulmuesve dhe te shpër-blyemve iu dha shuma prej 174.000 dinaresh.

Shpallje sulmuesash ne kolektivet pu-nonjese ne Janjeve

Kolektivet puntore te kooperatives metalurgjike „Eduard Kardelj" e te kooperatives zejtare „Ivo Lola Ribar" dhe te kooperatives shitblerse ne Jan-jeve kane shpalle 8 sulmuesa per an-gazhimin ne pune te vetmohueshme dhe per sukseset e arrijtuna ne tej-kalimin e kryemjes se detyrave te tyne ne prodhim gjate garave te nan-dorit. Sulmuesat jane shperblye me nji shume te hollash prej 14. 500 di-nareve. Veç ketyne jane lavdrue 9 puntore, 4 nepunsa dhe tre ekspertë n'ekonomi. Te lavdruemit u asht nda nji shperblim ne te holla prej 16.500 dinareve.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Miladin Popoviq„ Prishtine.
Pajtimi ne Rilindjen i pranon Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.

ARSIM E KULTURE

Hapja e kursit te dijes se pergjitheshme nga keshilli i sindikates se rrethit ne Prizren

Ne fillim te ketij muaji, keshilli i rrethit te sindikatave te Prizrenit e hapi kursin dymujuer te dijes se pergjitheshme per aftesimin e personelit sherbyes te zyrave shteterore te tudryshme, ne menyre qe ata te perfitojne gjate studes se duhun ne landet e kultures se pergjithshme per te cilat kane nevoje te domosdoshme, si per gjuhen serbokroate, historie etj.

Kursin e ndjekin 30 ndjekesa, te cilet kane premtue se do t'a vazhdojne rregullisht po sikur t'ishin ne shkolle te rregullt, sepse shumica prej tyne jane koshjent se prej mesimeve do te kene dobi te madhe n'aftesimin e tyne ideo-politik dhe kultural.

Per zhvillimin e landve jane perzgjedhe [illegible] te shkolles normale, te cilet me punen e tyne do te bajne qe keta kursista te perfitojne njiherit edhe teorikisht.

Ne mbarimin e ketij kursi, nji pjese e kursistave do te dergohet ne [illegible] e tudryshme per te [illegible] ne degen e administrates.

Nder keto dite do te hapet kursi i ketij rangu edhe per shqiptaret, per te cilin jane tue u ba pergatitjet e nevojshme.

R. Jusufi

Ne katundin Kopopove te rrethit te Kamenices nuk punojne kurset kundra analfabetizmit

Ne rrethin e Kamenices ka filluar kursi kundra analfabetizmit qysh me 15.X. 1948 [illegible]

[illegible]

Nga puna e shkolles s'ulte bujqesore ne Gilan

Ne rrethin e Gilanit gjinden 27 shkolla fillore, nji [illegible]

Nga Bashkimi Sovjetik

Miçurinasit ne veprim

Vepra e Miçurinit te madh, i cili per shume vjet me radhe [illegible] Rreth ketij jane gershetuar [illegible] populare ne BRSS.

[illegible]

Kolektivi shkencuer i bashkpuntoreve te stacjonit modeluer t'Altajit kryen nji pune te gjane kerkimesh shkencore. Me anen e selekcjonimit jane fitue lloje te reja, te cilet kane rezistence te madhe ne luften kunder mrazit te fort. Pervec mollave, dardhave, dredhave [illegible]

[illegible]

Nga konferenca e Partis se qytetit ne Mitrovice

Me date 1 te ketij muaji ne qytetin e Mitroveces u-ba konferenca e punes e Partis. Konferencen e hapi [illegible] i Komitetit te vendit shoku Llukiq Simonoviq, i cili propozoi zgjedhjen e keshillit te punes. Ky me nji here propozoi rendin e dites. [illegible] fjala delegatit te Komitetit Krahinuer shokut Predrag Ajtiq, i cili nder-mjet te tjerash vueni ne dukje rolin e Partis n'ekonomin lokale [illegible] Mbas tij u-lexue referati prej sekretarit politik te Komitetit te vendit. Mbas ketij u-lexue menjiehere referati organizativ, e pas tij filloi diskusjoni. Ne diskusjon ma teper u bisedue puna dhe roli i ndermarrjes „Trepça", ne te cilen ndermarrje asht ba nji pune kolosale gjate vjetit te dyte te Planit pesevjeçar.

Mandej me nji here u-ba zgjedhja e delegateve te Komitetit te vendit, delegatet per Kongresin e IV-te te Partis per Krahinen e Kosmetit dhe delegateve te Kongresit te II-te te Partis Komuniste te Serbis. Perveç ketyne u-ba zgjedhja edhe e komisjonit te revizjonit.

Mbas perfundimit te zgjedhjeve, delegatet e konferences propozuen me i dergue nji telegram KQ te PKJ dhe KQ te PKS.

Mazllum Raça

Ma fort kujdes per grumbullimin e misrit

Grumbullimi i misrit ne rrethin e Pejes asht tue u-zhvillue mjaft ngadale, me gjithese ka fillue me 18 nanduer. Deri tash grumbullimi asht plotesue vetem ne 30% simbas planit te parapame. Drejtorija e grumbullimeve ne ket rreth ende pak e ka nxane sa duhet ket problem per shkak te plogeshtis se tij. Simbas dispozitave te vertetueme dhe simbas planit te Keshillit krahinuer dhe te Ministris se tregtis e te furnizimit, drejtorija e grumbullimeve ne ket rreth duhet qe t'a kryeje planin deri me 1 kallnuer te vjetit t'ardhshem, çka do te thote qe ajo t'i grumbulloje te gjitha sasinat e parapame te misrit ne ket rreth.

I. V. SERGEJEV

Shkenca dhe bestytnija

[illegible]

Jo fort larg nder disa popuj t'Azis qendrore ka qene zakoni i egter i bestytnis qe t'i napin femijve te dashtun, veçanerisht djelmoshave me qellim emna me kuptim te keq. [illegible]

(Vazhdon)